



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 403/ 6 Prot.,

Datë 27.02.2025

V E N D I M

Nr. 305 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.02.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

Ankimues:

BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK me Nipte .L82210031Q , L42202028V.
Adresa:Rr. Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2.
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.),Adresa: Rajoni Nr.1, Rr: “Boris Plumbi”, Nr.20, Korçë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021
“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i
Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.01.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 04.02.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE, dhe ka kryer renditjen e rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe				
“PRIMUS ALBANIA” ShPK	me vlerë	937,500	Lek pa TVSH	Skualifikuar
2. “Tetra PRO” SHPK	“	989,000	“	Kualifikuar

II.3 Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti kontraktor më date **10.02.2025** ka publikuar Njoftim fituesi, për procedurën e prokurimit.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5040, datë 11.02.2025 dhe me Nr. 403/2025 Prot., date 11.02.2025 e BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ka publikuar formularin e publikimit nr. 403/1 prot., datë 12.02.2025 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.6. Nëpërmjet Shërbimit postar operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK ka përcjellë pranë KPP-së Formularin e Ankesës, shtojca 20, protokolluar me tonën me nr. 403/2, datë 12.02.2025.

II.7. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa nr. 41/21 prot., datë 12.02.2025 protokolluar me tonën me nr.403/3, datë 19.02.2025 me objekt “*Informacion për Vendimin e marrë nga KSHA*”.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin nr. 1, datë 19.02.2025, të KSHA-së ka vendosur mospranim të ankesës.

II.8. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, nuk janë paraqitur argumentet nga operatorë ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Lidhur me autorizimin që OE duhet të paraqesin nga prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave për Programin Kompjuterik “Al Billing”.

Bejme me dije se është administruar Autorizim Prodhuesi lëshuar nga shoqëria Primus Albania Sh.p.k., ku referohet se në bazë të Autorizim dt. 19.07.2016 kjo shoqëri të jetë titullar i të drejtave kompjuterike Al Billing. Me anë të këtij autorizimi shoqëria Primus Albania Sh.p.k. autorizon operatorin Nexia Al Consulting Sh.p.k., për të paraqitur oferte dhe me pas për të negociuar dhe nënshkruar kontratën me AK për procedurën me objekt “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike” me Nr. Ref. 35580-01-20-2025.

Gjithashtu është administruar Autorizim datë 19.07.2016 nga i cili rezulton se autorët Ilirjan Shkëmbi dhe Klodian Zyberi kanë autorizuar shoqërinë Jehona Softëare Sh.p.k. (sot shoqëria Primus Albania Sh.p.k) të ofrojë shërbimin e kërkuar për programin kompjuterik “AL Billing”.

Në bazë të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar, Neni 48 “Kontrata e së drejtës së autorit” pika 4 parashikohet se “Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat tre vjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer”.

Ne keto kushte mund të shprehemi se gjendemi përpara faktit që autorizimi i datës 19.07.2016 nga autoret tek shoqëria Jehona Softëare Sh.p.k. (sot shoqëria Primus Albania Sh.p.k) nuk është më në fuqi pasi afati pesë vjeçar ka përfunduar sikundër parashikuar në ligjin si më sipër cituar për pasojë shoqëria Primus Albania Sh.p.k., nuk mund të lëshojë një autorizim për operatorin Nexia Al Consulting Sh.p.k., me qëllim që kjo e fundit të paraqesë ofertë dhe të lidhë kontratë me AK për këtë objekt prokurimi.

Argumente të OE ankimes:

Ne dt. 10.02.2025 njoftohemi për fillimin e afatit të ankimimit. Vendimi i marë nga KVO e AK për refuzimin e ofertës së BOE Nexia al consulting sh.p.k. dhe Primus Albania sh.p.k. është i paargumentuar, i pabazuar dhe i pambështetur në kuadrin ligjor në fuqi. Më poshtë argumentet dhe faktet:

Sipas arsyesimit të KVO-së, kjo e fundit e ka pranuar dhe administruar autorizimin e prodhuesit/ autorit/ distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave: për programin kompjuterik Al Billing. Pra, nga ana formale ai autorizim është i rregullt. Ndërkohë ka evidentuar parregullsi në atë autorizim, si më poshtë:

Ne baze te ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar, neni 48 “kontrata e së drejtës së autorit” pika 4 parashikohet se:

Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat tre vjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për 5 vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer.

Ne keto kushte mund te shprehemi se gjendemi perpara faktit qe autorizimi i dates 19.07.2016 nga autoret tek shoqeria Jehona Software sh.p.k. (sot Primus Albania sh.p.k) nuk eshte me ne fuqi pasi afati 5 vjeçar ka perfunduar sikunder parashikuar ne Ligjin si me siper cituar per pasoje shoqeria Primus Albania sh.p.k., nuk mund te leshoje nje autorizim per operatorin Nexia AL Consulting sh.p.k., me qellim qe kjo e fundit te paraqese oferte dhe te lidhe kontrate me AK per kete objekt prokurimi.

Në autorizimin e prodhuesit të datës 19.07.2016 për programin kompjuterik Al-billing lëshuar nga dy autorët e programit I. Sh. dhe K. Z., ndër të tjera është cituar si bazë ligjor ku mbështetet ai autorizim Ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si më poshtë: Z. Ilirjan Shkambi lindur ne Korce, me date 30.01.1971, dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar si dhe mbajtes i mjetit te identifikimit nr. 029039853, ne cilesine e bashkeautorit te vepres programi kompjuterik AL-billing; ne zbatim te Kodit Civil te RSH, nenet 659 e ne vijim, si dhe Ligjit 9380, dt. 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te” palet bien dakord dhe shprehin me vullnetin e tyre te lire deklaraten si me poshte vijon:

Citimi i këtij ligji në këtë autorizim të datës 19.07.2016 nuk është një lapsus, por është baza ligjore dhe lëndore mbi të cilin është formuluar dhe miratuar ai autorizim nga të dy autorët e programit kompjuterik, ligj i cili ka qënë në fuqi në datën e nënshkrimit të autorizimit.

Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, që ka shfuqizuar Ligjin nr. 9380, date 28.04.2005, të cilin Ligj nr. 35/2016 citon KVO dhe mbi të cilin ka argumentuar mbi pavlefshmërinë e autorizimit të prodhuesit të paraqitur nga BOE, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 31.03.2016 dhe dekretuar nga presidenti i RSH në datë 14.04.2016. Ndërkohë neni 190 i ligjit nr. 35/2016 përcakton kohën kur Ligji hyn në fuqi, si më poshtë shkëputur nga Ligji: neni 189 shfuqizimi Ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, Per të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Neni 190 hyrja në fuqi ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në fletoren zyrtare. Miratuar në datën 31.3.2016 shpallur me dekretin nr. 9511, datë 14.4.2016, të presidentit të republikës së shqipërisë, bujar nishani pra, ligji nr. 35/2016 ka hyrë në fuqi 6 muaj pas botimit të fletoren zyrtare dhe ai ligj është botuar në fletoren zyrtare pas datës 14.04.2016, data e dekretimit të tij nga Presidenti i RSH, pra afërsisht në muajin tetor 2016.

Kësisoj, Autorizimi i Prodhuesit i lëshuar nga dy autorët e programit kompjuterik në datë 19.07.2016 korrektësisht ka të cituar dhe është bazuar në ligjin nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i cili ka qënë në fuqi datën e nënshkrimit të autorizimit. Ky ligj nuk ka kufizimet të cilat KVO ka cituar në arsyetimin e tij në mospranimin e autorizimit të prodhuesit. Ligji nr. 35/2016 që KVO referon në arsyetimin e tij nuk ka qënë në fuqi në datën e lëshimit të autorizimit të prodhuesve dhe kësisoj referimi në atë ligj (pavarësisht se edhe ai ligj nuk ka kufizimet që lidhen me afatet kohore të

vlefshmërisë përse i takon programeve kompjuterike, të cilat pretendon KVO) dhe citimet e tij në arsyetim nga ana e KVO-së janë të pavlefshme.

Pavarësisht shfuqizimit të ligjit 9380, date 28.04.2005 dhe hyrjes në fuqi në tetor 2016 të ligjit 35/2016, autorizimi i prodhuesit për programin AL-Billing lëshuar nga dy autorët e programit kompjuterik në date 19.07.2016 mbetet në fuqi dhe ka të njëjtat efekte si në datën e lëshimit të tij. Gjithsesi edhe për ti ardhur në ndihmë kvo/ ksha edhe duke ju referuar

Ligjit nr. 35/2016, (referencë ligjore e cila nuk aplikohet sic argumentuam dhe faktuam më lart për rastin tonë) sqarojmë: - neni 48 i atij ligji që KVO referon shprehet.

Autori mund ti kalojë një personi tjetër të drejtën për shfrytëzimin e veprës së tij letrare, shkencore, artistike, ndërkohë që programi kompjuterik nuk përfshihet në asnjërën nga këto kategori të sipërcituara, letrare, shkencore, artistike, referoju nenit 1, i cili qartëson objektin dhe qëllimin e ligjit, vecojmë gjërmën a dhe c, si më poshtë:

neni 1 objekti dhe qëllimi i ligjit

1. Objekt i këtij ligji janë: a) mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to për veprat e natyrës letrare, artistike dhe shkencore; c) mbrojtja e të drejtave të parashikuara në dispozitat e vecanta për programet kompjuterike dhe veprat audiovizuale të përcaktuara në këtë ligj; pra, ligjvënësi ka bërë një ndarje të qartë në përkufizim dhe në kuptim të këtij ligji ndërmjet veprave të natyrës letrare, artistike dhe shkencore me programet kompjuterike. - neni 48 pika 4 që citon KVO në arsyetim shprehet si më poshtë:

4. Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat tre vjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer.

Në arsyetimin e tij, KVO arrin në përfundimin se në autorizim nuk janë vendosur afate kohore, ndërkohë që autorizimi shprehet si më poshtë: autorizohet shoqëria Jehona Softëare sh.p.k, e rregjistruar ne QKR ne date me numer nipt l42202028v te ofroje sherbimin e kerkuar per programin kompjuterik AL Billing, ne te gjitha procedurat e prokurimit apo projektet ne te cilat eshte pjesemarrese.

Shoqëria Jehona Software shpk i kalohen të drejtat e përfaqesimit për të gjitha projektet si dhe për periudhën kohore në të cilën ai do të zgjase. Me anë të këtij autorizimi, bashkëautorët e lartpërmendur bien dakort të caktojnë shoqërinë Jehona Software shpk si titullare të këtyre të drejtave, nga momenti i nënshkrimit të Saj.

Për periudhën kohore në të cilën ai (nënkuptoni program kompjuterik) do të zgjasë. Pra, autorizimi ka një afat kohor të parashikuar që lidhet me jetëgjatësinë e vetë programit kompjuterik (afat i cili do të përcaktohet nga kërkesa e tregut për atë program kompjuterik), por gjithsesi është përcaktuar një afat kufizues dhe është një vullnet i lirë shprehur nga të dy autorët e programit kompjuterik.

Pra, edhe referuar ligjit nr. 35/2016, i cili gjithsesi nuk ka fuqi vepruese për autorizimin në fjalë, pasi ky ligj nuk ka qënë në fuqi datën e lëshimit të autorizimit, përsëri arsyetimi i KVO-së për refuzimin e autorizimit me argumentin e afatit të vlefshmërisë,

III.1.2. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcat 9, **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave:

- Për Programin Kompjuterik “Al Billing”

Argumentimi: Aktualisht Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë (SHRUKK) përdor: Sistemin e faturimit Al-Billing .

Suporti i prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.3. Referuar nenit 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtare.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

III.1.4. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Nenit 41/2/6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e Shërbimeve”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndyshuar, kërkohet shprehimisht:

2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet/shërbimet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë apo dokumente të tjera.

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet

me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik, në përmbushje të kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, ka depozituar në sistem dokumentet emërtuar si më poshtë vijon:

1. Autorizim_Prodhuesi _Certifikate te_drejtash_autori. Në brendi të të cilit gjenden:

-Çertifikatë Regjistrimi e Drejtë Autori për Veprën, Tiranë më 27.12.2011

- Program Kompjuterik “Al Billing”

Dokument i noterizuar.

- -Autorizim, që mban datën 19.07.2016. Në zbatim të Ligjit 9380, Dt. 28.04.2005, lëshuar nga bashkëautorët e veprës Program Kompjuterik “Al Billing”, me anë të të cilit autorizon shoqërinë “Jehona Software” ShPK (sot Primus Albania shpk) të ofrojë shërbimet e kërkuara për Programin Kompjuterik “Al Billing” në të gjitha procedurat e prokurimit. Shoqërisë i kalohen të drejtat e përfaqësimit.

Dokument i noterizuar.

- Autorizim Prodhuesi nga Primus Albania shpk, si titullar i të drejtave të programit kompjuterik Al Billing, sipas autorizimit të datës 19.07.2016, me anë të të cilit autorizon Nexia AL Consulting ShPK, për të paraqitur ofertë dhe negociuar.

2. Dokumenti Marrëveshje Bashkimi Shoqërish.

Datë 30.01.2025.

- Lidhur midis shoqërive: Primus Albania ShPK dhe Nexi AL Consulting ShPK për pjesëmarrje në tenderin me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

Autoriteti Kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave duke skualifikuar BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK me arsyetim, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...] Në baze të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar, Neni 48 “Kontrata e së drejtës së autorit” pika 4 parashikohet se “Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat tre vjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer”.

Ne keto kushte mund të shprehemi se gjendemi përpara faktit që autorizimi i datës 19.07.2016 nga autoret tek shoqëria Jehona Software Sh.p.k. (sot shoqëria Primus Albania Sh.p.k) nuk është më ne fuqi pasi afati pesë vjeçar ka përfunduar sikundër parashikuar në ligjin si më sipër cituar për pasojë shoqëria Primus Albania Sh.p.k., nuk mund të lëshojë një autorizim për operatorin Nexia Al Consulting Sh.p.k., me qëllim që kjo e fundit të paraqesë ofertë dhe të lidhë kontratë me AK për këtë objekt prokurimi.[...]

III.1.7. Autoriteti Kontraktor me vendimin e KSHA-së nuk pranon ankesën duke mbajtur të njëjtin qëndrim me KVO-në mbi arsyen e skualifikimit të ankimuesit.

III.1.8. Komisioni gjykon referuar dokumentacionit të dosjes administrative dhe referuar kritereve të veçanta të kualifikimit ku rezulton, se AK ka kërkuar shprehimisht në shtojcën 9, që: - *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave:*

- *Për Programin Kompjuterik “Al Billing” .*

Nisur nga arsyetja e skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstaton, se ky i fundit në përmbushje të kërkesës së AK-së ka paraqitur dokumentacionin sipërcituar, (pika III.1.6) i cili në kohën e hartimit e tij citon si bazë ligjore Ligjin nr. 9380, Dt. 28.04.2005 “Për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe si rrjedhojë Autorizimi, datë 19.07.2016, nuk ka kufizim kohor të së drejtës së përdorimit të programeve kompjuterike, (nenit 83 i Ligjit).

Nga ana tjetër Autoriteti Kontraktor i ndodhur në një regjim juridik të ndryshëm, si rrjedhojë e shfuqizimit të Ligjit nr. 9380, Dt. 28.04.2005 me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ka kryer vlerësimin e ofertës së ankimuesit bazuar në nenin 48/4 të Ligjit nr. 35/2016, ku referohet: *4.Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat trevjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer, në lidhje me afatet e vlefshmërisë së dokumentit Autorizim.*

Komisioni, referuar dokumenteve të dosjes administrative gjykon, se Autoriteti Kontraktor bazuar në nenin 92/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ka detyrimin procedural që të kryejë verifikimet përkatëse apo të kërkojë sqarime nga operatori ekonomik, mbi vlefshmërinë e dokumenteve objekt skualifikimi, gjë për të cilin rezulton se AK nuk i ka kryer.

Autoritetit kontraktor, për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë në përmbushje të qëllimit të *lex specialis* të parashikuar në nenin 2 të tij.

Përsa referuar Komisioni gjykon, se Autoriteti Kontraktor duhet të kryejë rivlerësimin e ofertës së ankimuesit duke kërkuar sqarime dhe verifikime përkatëse lidhur me dokumentet e paraqitura dhe vlefshmërinë e tyre, në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor, në shtojcën 2, Kriteret për kualifikim, kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit/ autorit/ distributorit të autorizuar, për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

Përsa referuar pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

